



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 prill 2023  
Nr.ref.:RK 2150/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI213/21**

**Parashtrues**

**“N.T. Doli”**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Ac. nr. 5805/2020], të 19 tetorit  
2021 të Gjykatës së Apelit**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Kompania “N.T. Doli” me seli në Gjakovë, e përfaqësuar nga pronari i saj Armend Doli, nga Gjakova (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Ac. nr. 5805/20], të 19 tetorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [CP. nr. 10/13], të 8 shtatorit 2017, të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 22 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 24 nëntor 2021.
6. Më 3 dhjetor 2021, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. Gjr. KI213/21] caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 2 dhjetor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
8. Më 1 korrik 2022, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të plotësoj formularin zyrtar të kërkesës dhe t' i dorëzojë të gjitha vendimet dhe ankesat që ndërliidhen me rastin e posaçërisht Aktvendimin [CP. nr. 10/2013] e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 8 shtatorit 2017 dhe ankesën kundër këtij aktvendimi.
9. Më 4 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin zyrtar të kërkesës dhe ankesën drejtuar Gjykatës së Apelit kundër Aktvendimit [CP. nr. 10/2013] të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 8 shtatorit 2017.
10. Më 12 tetor 2022, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë autorizimin që dëshmon se e përfaqëson kompaninë "N.T. Doli" para Gjykatës.
11. Më 11 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentacionin që dëshmon se është pronar i kompanisë "N.T. Doli".

12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 22 mars 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Nga shkresat e lëndës rezulton se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëtejme: KPMM), në cilësinë e kreditorit ka ushtruar propozim për përmbarim ndaj parashtruesit të kërkesës lidhur me pagesën e gjobës në shumën prej 3,968.48 euro (tre mijë e nëntë qind e gjashtëdhjetë e tetë euro e dyzetë e tetë cent) duke u bazuar në Aktvendimin [nr. 5026] e KPMM-së të 20 shtatorit 2011, i cili aktvendim ishte i plotfuqishëm nga 18 maji 2012 dhe i ekzekutueshëm nga 3 qershori 2012.
15. Më 3 janar 2013, Gjykata Komunale në Gjakovë përmes Aktvendimit [Cp. nr. 10/13] lejoi përmbarimin e kërkuar nga KPMM.
16. Më 4 mars 2016, parashtruesi i kërkesës ushtroi prapësim kundër Urdhrit për përmbarim.
17. Më 21 prill 2016, KPMM paraqiti përgjigje në prapësim.
18. Më 10 maj 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit [E. nr. 10/13] refuzoi si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi aktvendimin për lejimin e përmbarimit.
19. Kundër këtij aktvendimi, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit.
20. Më 18 gusht 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3792/16] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ktheu rastin për rivendosje në Gjykatën Themelore.
21. Më 8 shtator 2017, Gjykata Themelore në Gjakovë, në riprocedurë, përmes Aktvendimit [CP. nr. 10/13] refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [CP. nr. 10/13] të 3 janarit 2013 përmes të cilit ishte përcaktuar përmbarimi sipas precizimit të përmbarimit në vlerë prej 3,968.48 euro.
22. Më 19 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [Cp. nr. 10/13] të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 8 shtatorit 2017, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi i kontestuar të prishet dhe çështja t'i kthehet organit të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo të ndryshohet, duke aprovuar ankesën e debitorit duke lënë jashtë fuqie të gjitha veprimet përmbarimore.
23. Në ankesën e parashtruesit drejtuar Gjykatës së Apelit ai pretendonte se (i) Gjykata Themelore në Gjakovë nuk ka kompetencë që të vendos lidhur me përmbarimin e gjobës të përcaktuar nga KPMM-ja; dhe (ii) Aktvendimi për përmbarim nuk ka klauzolën e plotfuqishmërisë.
24. Më 19 tetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 5805/20] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pathemeltë dhe vërtetoi Aktvendimin [CP. nr. 10/13] e 8 shtatorit 2017, me arsyetimin se ky i fundit nuk ishte i përfshirë në shkelje

thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se drejt është vërtetuar gjendja faktike.

25. Gjykata e Apelit përmes të njëjtit aktvendim sqaroi si në vijim:

*“Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktvendimi i lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nr. 5026 i datës 20.09.2011, i cili vendim është i plotfuqishëm nga data 18.05.2012 dhe i ekzekutueshëm nga data 03.06.2012, në rastin konkret është dokument përmbarues, siç parashihet në nenin 22, paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, e cila dispozitë përcakton se: "Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative" dhe i njëjti përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: "Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executiunis) dhe dokumenti të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta, respektivisht Aktvendimi i kontestuar [Ac. nr. 5805/20] i 19 tetorit 2021 i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë në shkelje të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
27. Parashtruesi i kërkesës thekson: **“Vendimi i Organit të administratës është kundër kushtetues pasi që organet e administratës shtetërore nuk mund të shqiptojnë dënime e as gjoba në shuma aq të larta. Gjykimi i gjobës nga një organ i administratës para arbitraritetit dhe shkelja e njëanshme e fortë ligjore që paraqet shkelje kushtetuese, të drejtën në pronë në gjykim të drejtë dhe korrekt”.**
28. Parashtruesi i kërkesës me tej thekson: **“Para së gjithash Gjykata Themelore në Gjakovë nuk është as kompetente lëndore e as vendore për përmbarimin e gjobës administrative të shqiptuar, të kundërvajtës të shqiptuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Prishtinë, Gjykata nuk përmbaron gjoba, taksa dhe tatime, përkatësisht detyrime fiskale. Andaj, propozimi për përmbarim do të duhet të hedhet poshtë-të flaket për shkak të in kompetencës absolute të gjykatës. Për pasojë propozimi për këtë shkak duhet flakur”.**
29. Parashtruesi i kërkesës në vazhdim shton se **“Komisioni i pavarur për Miniera dhe minerale, Prishtinë nuk ka legjitimitet aktiv, nuk mundë të jetë palë në procedurë të këtillë, nuk e ka cilësinë e personit juridik e as fizik, në kuptim të nenit 73 të LPK-së. Në situata të tilla Gjykata Supreme e Kosovës nuk i ka pranuar cilësinë e palës, për shembull, Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.**
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se KPMM, në cilësinë e kreditorit, ka parashtruar përmbarimin duke u bazuar në Aktvendimin [nr. 5026] të 20 shtatorit 2011, ndërsa përgjatë procesit gjyqësor çështjen e parashkrimit dhe të aplikueshmërisë së ligjit të rastit konkret nuk e ka trajtuar gjatë shqyrtimit në gjykatat e rregullta.
31. Në lidhje me këtë pretendim specifik, parashtruesi i kërkesës thekson se **“Çështja e parashkrimit nuk është trajtuar. Në nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 për Ligjin në fuqi në Kosovë është paraparë .... a)**

*Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. B. Legjislacioni në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to”.*

32. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson: “Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, 2 por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim e zbaton atë ligj”.
33. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson: “çështja e parashkrimit deri me datën 22 mars 1999 ka qenë e rregulluar me LMD, neni 371, dhe afati i parashkrimit ishte 5 (pesë) vjet. Andaj , dispozita e nenit 34 të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet detyrimore "Gazeta zyrtare e RFJ-së" 31/93 e dt. 18.06.1993, e cila ka hyrë në fuqi me dt. 25.06.1993 e cila dispozitë e rregullon ndryshe atë lëmi nga ajo e rregulluar me dispozitë ligjore në fuqi deri më 22 mars 1999 është **DISPOZITË E PAAPLIKUESHME**, e cila as përjashtimisht **NUK MUNDË TË APLIKOHET**, pavarësisht se është jodiskriminuese, prej nga del se neni 34 i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet detyrimore "Gazeta zyrtare e RFJ-së" 31/93 i dt. 18 qershor 1993 është ligj për Kosovë i paaplikueshëm”.
34. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulojë Aktvendimin [Ac. nr. 5805/20] e 19 tetorit 2021, të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [A. nr. 621/13] e 25 gushtit 2020, të Gjykatës Themelore.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

#### **Neni 32**

#### **[E Drejta për Mjete Juridike]**

*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.*

#### **Neni 46** **[Mbrojtja e Pronës]**

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
- 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
- 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

#### **Neni 102** **[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]**

- 1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.*
- 2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.*
- 3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*
- 4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*
- 5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.*

#### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

#### **Neni 6** **(E drejta për një proces të rregullt)**

- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

## **Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbaremore i 31 janarit 2013**

### **Neni 5 Kompetenca**

1. Përmbarimin e cakton dhe zbaton organi përmbarues i paraparë me këtë ligj, po që se me ligj tjetër nuk është paraparë ndryshe.
2. Gjykata kompetente ka kompetencë lëndore për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës në pajtim me dispozitat e këtij ligji përveç nëse gjykatat dhe autoritetet tjera përmbareuse kanë juridiksionin për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës.
3. Përmbaruesi privat nxjerr urdhër në bazë të propozimit për kryerje të përmbarimit dhe kryen përmbarimin me qëllim të plotësimit të kërkesës së debitorit në bazë të dokumentit përmbarues, përveç nëse ndryshe parashikohet me ligj që urdhëron që përmbarimi dhe kryerja e përmbarimit të bëhet brenda juridiksionit të Gjykatës.
4. Kompetenca territoriale për të vendosur për çështjet lidhur me aplikimin e procedurave përmbaremore caktohet me dispozitat e këtij ligji, varësisht nga mjetet dhe objekti i përmbarimit, si dhe në bazë të statusit të organit përmbarues.
5. Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbareuse sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbaruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarimi.
6. Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore lidhur me:
  - 6.1. të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe
  - 6.2. kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera.

[...]

### **Neni 21 Bazat juridike për caktimin e përmbarimit**

“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”.

## Neni 22 Dokumenti përmbarues

1. *Dokumente përmbaruese janë:*

1.1. *vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;*

1.2. *vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia);*

[...]

### Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbyshur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

37. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e personit juridik, paraqet ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës [KI41/09](#), parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

39. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbyshur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

### Neni 47 [Kërkesa individuale]

1. *Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*



2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

40. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ. nr. 29/2021] e 29 prillit 2021 të Gjykatës Supreme, dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
41. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 1 (1, b) dhe (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

(1) *“Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:*

*[...]*

*(b) janë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj kundër Aktgjykimin ose aktvendimit të kontestuar;*

*[...]*

(2) *Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

42. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#)

(vendim) nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës* (vendim) nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNJ-së, Kemmachev kundër Francës, nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituaniës*, nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe Trofimchuk kundër Ukrainës, nr. 4241/03, kategoria (iii)).

43. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar [Ac. nr. 5805/20] i 19 tetorit 2021 i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
44. Gjykata, në vijim, do të trajtojë veç e veç secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

#### ***Pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së***

45. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke arsyetuar **(i)** mungesën e juridiksionit të gjykatave të rregullta/organeve administrative për të vendosur lidhur me përmbarimin; dhe **(ii)** mostrajtimin nga gjykatat e rregullta të çështjes së parashkrimit dhe aplikueshmërisë së ligjit të duhur në rrethanat e rastit konkret.

#### ***(i) Pretendimi për mungesë të juridiksionit për të vendosur lidhur me çështjen e përmbarimit***

46. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës konteston juridiksionin e gjykatave të rregullta dhe organeve administrative për të vendosur lidhur me çështjen e përmbarimit në rastin e tij.
47. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se “*Vendimi i Organit të administratës është kundërkushtetues, pasi që organet e administratës shtetërore nuk mund të shqiptojnë dënime e as gjoha në shuma aq të larta. Gjykimi i gjobës nga një organ i administratës para arbitraritetit dhe shkelja e njëanshme e fortë ligjore që paraqet shkelje kushtetuese, të drejtën në pronë në gjykim të drejtë dhe korrekt*”.
48. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës më tej thekson: “*Para së gjithash Gjykata Themelore në Gjakovë nuk është as kompetente lëndore e as vendore për përmbarimin e gjobës administrative të shqiptuar, të kundërvajtjes të shqiptuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Prishtinë, Gjykata nuk përmbaron gjoha, taksa dhe tatime, përkatësisht detyrime fiskale. Andaj, propozimi për përmbarim do të duhet të hedhet poshtë të flakët për shkak të in kompetencës absolute të gjykatës. Për pasojë propozimi për këtë shkak duhet flakur*”.

49. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimin për mungesë të kompetencës së Gjykatës Themelore në Gjakovë e kishte ngritur përmes ankesës edhe në Gjykatën e Apelit krahas pretendimit për mungesë të dokumentit me titull përmbarues.
50. Në kontekst të këtij pretendimi, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës kishte konstatuar se *“Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafët 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejt është vërtetuar gjendja faktike [...]”*.
51. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës po ashtu konteston kompetencën e gjykatave të rregullta për të vendosur lidhur me përmbarimin në rastin e tij.
52. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 5805/20] të 19 tetorit 2021 kishte theksuar se *“... aktvendimi i lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nr.5026 i datës 10.09.2011, vendimi i cili është i plotfuqishëm nga data 18.05.2012 dhe i ekzekutueshëm nga data 03.06.2012, në rastin konkret është dokument përmbarues, siç parashihet në nenin 22, paragrafi 1.pika 1.2 të LPP-së, e cila dispozitë përcakton se **“Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative”** dhe i njëjti përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se **“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”**”*.
53. Në këtë kontekst, Gjykata do t’i referohet nenit 21 [Bazat juridike për caktimin e përmbarimit] të LPP-së, i cili thekson se organi përmbarues e cakton/zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues.
54. Lidhur me dokumentin përmbarues, Gjykata do t’i referohet nenit 22 [Dokumenti përmbarues] i LPP-së, i cili përcakton se dokumentet përmbaruese janë, ndër të tjerash:
- [...]*
- 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;
- 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia); [...].”
55. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se KPMM në cilësinë e kreditorit kishte ushtruar propozim për përmbarim ndaj parashtruesit të kërkesës lidhur me pagesën e gjobës në shumën prej 3,968.48 euro (tre mijë e nëntë qind e gjashtëdhjetë e tetë euro e dyzetë e tetë cent), **duke u bazuar në Aktvendimin [nr. 5026] e KPMM-së të 20 shtatorit 2011**. Ndërsa, Gjykata Komunale në Gjakovë përmes Aktvendimit [Cp. nr. 10/13] lejoi përmbarimin e kërkuar nga KPMM, përmbarim i cili ishte aprovuar edhe përmes Aktvendimit [Ac. nr. 5805/20] të 19 tetorit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimit [CP. nr. 10/13] të 8 shtatorit 2017 të Gjykatës Themelore në Gjakovë.
56. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu do t’i referohet edhe nenit 5 [Kompetenca] të Ligjit nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarimore, i cili parasheh si në vijim:

*“Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbaruese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbaruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarimi”.*

57. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre në kontekst të refuzimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës ishin bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarimore dhe Ligjin nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore, në bazë të të cilave ishte zhvilluar procedura para gjykatave të rregullta. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore kishin sqaruar se Aktvendimi [nr. 5026] i 20 shtatorit 2011 i KPMM-së është dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit.
58. Gjykata vë në pah qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë konstatimit të fakteve apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, [KI86/11](#), parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
59. Gjykata tutje, rikujton se dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe të njëjtat dispozita as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI118/17](#) parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2018, paragrafi 36; [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 54; dhe [KI99/19](#), parashtruese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48, dhe së fundmi rastin [KI68/21](#), parashtrues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 8 shtatorit 2021, paragrafi 51).
60. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit për mungesë të kompetencës së Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe për mungesë të dokumentit me titull përmbarues në Gjykatën e Apelit, refuzohen si qartazi i papabazuar.

**(ii) Pretendimi lidhur me çështjen e parashkrimit dhe aplikueshmërisë së ligjit**

61. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës pretendon se KPMM, në cilësinë e kreditorit i është parashtruar përmbarimi duke u bazuar në Aktvendimin [nr. 5026] e 20 shtatorit 2011, ndërsa përgjatë procesit gjyqësor çështjen e parashkrimit dhe të aplikueshmërisë së ligjit nuk e ka trajtuar gjatë vendosjes në rastin konkret.

62. Në lidhje me këtë pretendim specifik, parashtruesi i kërkesës thekson se “Çështja e parashkrimit nuk është trajtuar. Në nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 për Ligjin në fuqi në Kosovë është paraparë .... a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to; b) Legjislacioni në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989. Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to”.
63. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson: “Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim e zbaton atë ligj”.
64. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson: “Çështja e parashkrimit deri me datën 22 mars 1999 ka qenë e rregulluar me LMD, neni 371. dhe afati i parashkrimit ishte 5 (pesë) vjet. Andaj , dispozita e nenit 34. të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet detyimore "Gazeta zyrtare e RFJ-së" 31/93 e dt. 18.06.1993, e cila ka hyrë në fuqi me dt. 25.06.1993 e cila dispozitë e rregullon ndryshe atë lëmi nga ajo e rregulluar me dispozitë ligjore në fuqi deri më 22 mars 1999 është DISPOZITË E PAAPLIKUESHME, e cila as përjashtimisht NUK MUNDË TË APLIKOHET, pavarësisht se është jodiskriminuese, prej nga del se neni 34 i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet detyimore "Gazeta zyrtare e RFJ-së" 31/93 i dt. 18 qershor 1993 është ligj për Kosovë i pa aplikueshëm”.
65. Gjykata, para së gjithash, rikujton se çdo pretendim i ngritur në kërkesë nga parashtruesi i kërkesës kërkon dhënien e një përgjigjeje konkrete nga ana e Gjykatës, me kushtin që kërkesa t’i përmbushë kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Njëri ndër to është edhe ai i shterimit të mjeteve efektive juridike në procedura të rregullta pranë gjykatave të juridiksionit të rregullt.
66. Gjykata tashmë ka një praktikë të konsoliduar përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin e materies/substancës (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera rastin e Gjykatës [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Barbas”, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 gushtit 2019, paragrafët 90-96, dhe së fundmi, rastin [KI189/19](#), parashtrues Alban Miftaraj, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59). Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton detyrimin e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin e materies/substancës, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNj. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës i kanë shfrytëzuar ato në të dyja kuptimet, në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KI71/18](#), parashtrues Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; [KI119/17](#), parashtrues Gentian Rexhepi, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafin 73; dhe rastin [KI154/17](#) dhe [05/18](#), cituar më lart, paragrafin 94).

67. Aspekti i shterimit të mjeteve juridike në substancë është i përcaktuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së dhe të Gjykatës dhe nënkupton që pretendimet për shkelje të KEDNj-së dhe të Kushtetutës, duhet të jenë ngritur “të paktën në substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që të njëjtave t’u jetë dhënë mundësia për të adresuar pretendimet për shkelje përkatëse (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti [KI01/19](#), parashtrues: *Fatos Rizvanolli*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 2 shtatorit 2020, paragrafët 96-100 dhe referencat e cituara në këtë rast).
68. Në këtë drejtim, GJEDNj gjithashtu përcakton që parashtruesit e kërkesave nuk mund të lirohen nga detyrimi i shterimit të mjeteve efektive juridike, edhe nëse gjykatat e rregullta mund të kenë qenë të detyruara të shqyrtojnë vet (*ex officio*) pretendimet përkatëse (shih, për më tepër përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin e materies/substancës, udhëzuesin e GJEDNj-së, të 31 gushtit 2022, Pjesa I. Bazat procedurale të papranueshmërisë; A. Mosshterimi i mjeteve juridike; 2. Aplikimi i rregullit; d. Pretendimet e Ngritura në Substancë).
69. Për më tepër, GJEDNj mban qëndrimin se mjete juridik duhet të shfrytëzohet, për aq sa ekziston një mjet i tillë që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë të paktën në substancë argumentin për shkelje të një të drejte. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur pranë gjykatave të rregullta, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, kur ka mundur të ngrihet nga parashtruesi i kërkesës gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi kjo të cilën synon ta ofrojë rregulli për shterimin e mjeteve juridike (shih rastin e GJEDNj-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, [KI119/17](#), cituar më lart, paragrafin 72, dhe së fundmi rastin [KI189/19](#), parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59).
70. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ngritur këtë pretendim as si të nënkuptuar dhe as në materie (substancë) para gjykatave të rregullta. Prandaj, Gjykata e ka të pamundur ta trajtojë dhe analizojë tutje këtë pretendim në materie, ngase kërkesa në këtë pjesë nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, në kuptim të ngritjes së shkeljes në substancë në gjykatat e rregullta (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës [KI68/21](#), parashtrues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 3 nëntorit 2021, paragrafët -58-66).
71. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet të refuzohet si pretendim i papranueshëm në baza procedurale, për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

### ***Pretendimi për shkelje të nenit 32 dhe 46 të Kushtetutës***

72. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
73. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm përmend nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, megjithatë, ai nuk shtjellon tutje, se si dhe pse ka ardhur deri të shkelja e këtij neni specifik. Gjykata përsërit se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, parashtruesit e kërkesës

duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri*, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) cituar më lart, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).

74. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së "drejtës për mjete juridike" dhe të së "drejtës pronësore" i përket kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve "të pambështetura ose të paarsyetuara", andaj si i tillë i njëjti, duhet shpallur qartazi i pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

### ***Pretendimi për shkelje të nenit 102 të Kushtetutës***

75. Përtej pretendimeve për shkeljen e neneve të lartcekura, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
76. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për "gëzimin e të drejtave dhe lirive" që garantohen me dispozitat e Kapitullit II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, këto nene në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohen nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njëres ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me "gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut" (shih, *inter alia*, rastet e GJEDNJ-së, [E.B. kundër Francës](#), nr. 43546/02, Aktgjykim i 22 janarit 2008, paragrafi 47; [Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 29381/09 dhe 32684/09, Aktgjykim i 7 shtatorit 2013, paragrafi 72; gjithashtu rastin e Gjykatës [KI67/16](#), parashtrues i kërkesës *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, paragrafi 128).
77. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
78. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse argumentet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës.
79. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (1,b) dhe (2) si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 22 mars 2023, njëzëri:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani